

NDRYSHIME TË SKK 13

“AKTIVET BIOLOGJIKE DHE MARRËVESHJET KONCESIONARE” -

I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 4, 5, 8, 9, 13, 15, 16, 29 dhe 34 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 13 *Aktivitetet Biologjike dhe Marrëveshjet Koncesionare* (SKK 13 i përmirësuar) miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm për aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin Nr. 25 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në maj 2018.

2. SKK 13 mbështetet në SNK 41, *Bujqësia*. SKK 13 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 34 *Aktivitetet e Specializuara* të SNRF për NVM (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 35. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 13 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin 11 të Ligjit nr. 25, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në maj 2018.

FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky Standard do të zbatohet për:

- (a) aktivet biologjike (përfshirë të gjitha aktivet biologjike, përveç tokave të përdorura për veprimtari bujqësore (shiko SKK 5, *Aktivitetet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale*) dhe prodhimin bujqësor, i cili kontabilizohet si inventar që nga momenti i përfutimit (shiko SKK 4, *Inventarët*), dhe
- (b) marrëveshjet koncesionare.

5. Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore të përdorura në këtë standard:

Aktiviteti bujqësor është menaxhimi nga ana e një njësie ekonomike i transformimit biologjik të aktiveve biologjike në prodhim bujqësor për shitje ose në aktive të tjera biologjike.

Prodhimi bujqësor është prodhimi i përfutur nga aktivet biologjike të njësisë ekonomike.

Aktivi biologjik është një kafshë e gjallë ose bimë.

Transformimi biologjik përfshin proceset e rritjes, shndërrimit, prodhimit dhe mbarështimit që sjellin ndryshime cilësore e sasiore në aktivin biologjik.

Politikat kontabël për aktivet biologjike

8. Një njësi ekonomike që zbaton këtë standardsepse kryen aktivitet bujqësor, duhet të përcaktojë politikën e saj kontabël për çdo klasë të aktiveve biologjike si më poshtë:

(a) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 12-14 për ato aktive biologjike për të cilat vlera e drejtë është menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta;

(b) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e kostos në paragrafët 15-16 për gjithë aktivet e tjera biologjike.

Njësitë e vogla ekonomike inkurajohen por nuk janë të detyruara në zbatimin e pikës (a) të këtij neni. Këto njësi ekonomike përdorin modelin e kostos për të gjitha aktivet e tyre biologjike.

Njohja fillestare

9. Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur:

(a) njësia ekonomike kontrollon aktivin biologjik / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara;

(b) është e mundshme që në njësinë ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin biologjik/ produktin bujqësor; dhe

(c) vlera e drejtë ose kosto e aktivit biologjik / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.

MATJA DHE VLERËSIMI I MËPASSHËM

Matja-modeli i vlerës së drejtë

13. Produktet bujqësore të përfuara nga aktivet biologjike të një njësie ekonomike, duhet të maten në njohje me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në momentin e përfutimit. Kjo vlerë e matur përbën koston në datën e përfutimit, kur zbatohet SKK 4 *Inventarët*.

Matja – modeli i kostos

15. Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive biologjike vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë.

16. Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruar nga aktivet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në momentin e përfutimit. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese për aktivet biologjike

Aktivitet biologjike të mbajtura me vlerë të drejtë

29. Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivet biologjike të matura me vlerën e drejtë:

(a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve të saj biologjike.

(b) metodat dhe supozimet domethënëse të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të çdo kategorie të produkteve bujqësore në momentin e përfundimit dhe çdo kategorie të aktiveve biologjike.

(c) një rakordim të ndryshimeve në vlerën kontabël të aktiveve biologjike ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës aktuale. Rakordimi duhet të përfshijë:

(i) fitimin ose humbjen që lind nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes.

(ii) rritjet që rezultojnë nga shitjet.

(iii) rëniet që rezultojnë nga vjelja.

(vi) ndryshime të tjera

DATA E HYRJES NË ZBATIM

34. Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe do të zbatohen në prospektivë.